Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
**611-24-11280-5-3-6/C812**

# K O N T R A T Ë /SHERBIM

Emri i Projektit **Renovimi i nyjeve sanitare ne shkolla**

Numri identifikues: : **611-24-11280-5-3-6, Datë: 14.10.2024;** Nr. i arkivit; **400-01- 57652**

## PALËT NË MARRËVESHJE

**KOMUNA E DRENASIT - Drenas**, përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës").

**Treing SH.P.K., Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69, Prishtinë,** përfaqësuar nga Uljan Thaçi-Drejtor

### Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Renovimi i nyjeve sanitare ne shkolla**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

**2.1** Vendi i pranimit të **sherbimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1].
Periudha e kryrjes se punëve/**shërbimeve** dhe furnizimeve do të jetë deri në afatin **: 10 dite.**

### Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **9,996.34** €; [***Nentëmij Nentëqindë Nentëdhjetë e Gjashtë euro e 34 cent*** ]

**3.1** Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

**3.2** Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

### Neni 4 Pagesat

**4.1** Pagesa do të bëhet në Euro.
Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

**4.4** Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **sherbimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DREJTORIA E ARSIMIT

a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumetat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **sherbimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.

b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **sherbimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.

c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumetat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj.Poashtu obligohet që dokumetet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

## Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

**5.1** Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

**5.2** Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## Neni 6 Kualiteti

**6.1** Kualiteti i furnizimeve/**shërbimeve/**punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

## Neni 7 Garancioni i sherbimeve

**7.1** Garancioni PER ELIMINIM TE DEFEKTEVE eshte Nje vite.

## Neni 8 Vonesat në ekzekutim

**8.1** Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [ të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[sherbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

**9.1** Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## Neni 10 Nën-kontraktimi

**10.1** Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

**11.1** Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim,

korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

**12.1** Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

**13.1** Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

.**13.2** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në në pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

**Neni 14 Komunikimi**

**14.1** Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.
E hartuar në gjuhen **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.
Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjehere pas nenshkrimit. .**

| **Për Autoritetin Kontraktues** | | **Për Kontraktuesin** | |
|---|---|---|---|
| Emri: | **GENTIANA QELA** | Emri: | Uljan Thaçi |
| Pozita: | **ZPP** | Pozita: | **DREJTOR** |
| Nënshkrimi: | [signature] | Nënshkrimi: | [signature] |
| Data: | 04.12.2024 | Data: | 04.12.2024 |
| Vula: | [stamp: REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY - KOMUNA GLLOGOC] | Vula: | [stamp: SH.P.K TREING PRISHTINË] |

EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH

09888

Për: KOMUNA GLLOGOC
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: Treing SH.P.K, Rr. Dëshmorët e Ponoshecit nr 69, Prishtinë
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NE SHKOLLA

Numri i prokurimit: 611-24-11280-5-3-6

# SIGURIA E EKZEKUTIMIT

## Garancion

## Nr.Serik i polices: 749/24

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;
DHE NGASE NE jemi pajtuar t`i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **999.63 ( nëntë qind e nëntëdhjetë e nëntë, e gjashtëdhjetë e tre të qindtat Euro** ) zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **999.63 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

**Kjo siguri është e vlefshme 62 ditë prej 04.12.2024 deri më 03.02.2025**

KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.**
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 04.12.2024

# PARAMASA DHE PARALLOGARIA

## Renovimi dhe ri-organizimi i nyjeve sanitare në shfmu"Xhevë Lladrovci" Gllanaselle

Punimet duhet të kryhen në përputhshmëri te plote me kete paramase dhe skicat dhe standardet EC dhe ISO.
Gjatë puneve të demolimit, punëkryesi duhet të këtë kujdes që të mos demtoj pjese tjera të cilat nuk janë parapare për demolim. Cdo demtim, punëkryes obligohet qe ta riparoj dhe ta kthej ne gjenjde fillestare. Punkryesi eshte i obliguar qe pas perfundimit te punimeve, ta bej pastrimin e zones, bartjen dhe transportin e materialit te panevojshem deri ne deponi te percaktuar nga organi mbikqyres. Në çmim përfshihet tvsh dhe të gjitha taksat dhe tatimet.

### I. Punët e Dëmolimit dhe Çmontimit

| Pos | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| I.1 | Demontimi i dy radiatorve ekzistues 22-600/600 se bashku me gypat dhe rujtja për rimontim. | komp | 1.00 | 1.00 | € 1.00 |
| I.2 | Demolimi i mureve të brendshme ndarse të Toileteve ekzistuese të shkollës sipas projektit. Demolimi duhet të behet se bashku me pllakat qeramike, dyert nga pvc, elementet sanitare instalimet etj. Dhe matariali dërgohet në deponi. | m² | 78.00 | 1.00 | € 78.00 |
| I.3 | Demolimi i pllakave qeramike nga muret e toileteve dhe bartja e materialit deri në deponi. | m² | 40.44 | 1.00 | € 40.44 |
| I.4 | Demolimi i dyshemes në nyjet ekzistuese sanitare, përfshirë pllakat qeramike, shtresen e estrihut, termoiziolimin, instalimet dhe elementet sanitare dhe dërgimi i materialt në deponi përkatëse. | m² | 27.00 | 1.00 | € 27.00 |
| I.5 | Demontimi i derës nga PVC me dim. 80x210cm, si dhe demolimi i murit rreth kësaj dere për krijimin e hapësires për vendosjen e derës se re më dimensione 100x210cm, për toiletin persona me aftësi të kufizuara. | komp | 1.00 | 10.00 | € 10.00 |
| | | | | Total I: | 156.44 |

| II. Punët e muratimit, suvatimit dhe ngjyrosjes | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| II.1 | Furnizimi me gjithë materialin e nevojshem dhe punimi i murëve ndarese me trashësi t=12cm me blloka argjille me vrima gjysem giter e me llaç vazhdues. Murët punohen me lartësi h=2m. Në çmim përfshihet edhe ankerimi në murët ekzistuese. | $m^2$ | 43.40 | 2.00 | 86.80 |
| II.2 | Furnizimi me materialin e nevojshem dhe suvatimi me llaq i mureve të reja në nyjet sanitare dhe mureve ku janë demoluar pllakat ekzistuese, kjo më qëllim të përgaditjes së sipërfaqës për pllaka. | $m^2$ | 127.24 | 1.00 | 127.24 |
| II.3 | Furnizimi me material dhe punimi me fasadë 1.0mm, i pllafonit në nyjet sanitare, përfshirë edhe murët që nuk veshen me pllaka. | $m^2$ | 47.4 | 1.00 | 47.42 |
| II.4 | Furnizimi me material dhe ngjyrosja e sipërfaqës së fasades nga pozicioni paraprak më një shtresë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të plastifikuar që pastrohet plotësisht me uji. | $m^2$ | 47.4 | 1.00 | 47.42 |
| | | | | Total II | 308.88 |

| III.Punët e Dyshemës dhe pllakave | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| III.1 | Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit (estrihut) në dyshemen e nyjeve sanitare.<br>Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim:<br>• Estrih t=5 cm<br>• Termoizolim stiropor N3, t=3 cm | $m^2$ | 27.0 | 2.00 | 54.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| III.2 | Furnizimi me gjithë materialin e nevojshem dhe punimi i dyshemes dhe murëve me pllaka qeramike. Pllakat duhet janë të klasit të parë, më prerje laserike, tipi MAT, me dim. 60x120cm dhe ngjitën me ngjitës kualitativ. Në çmim parashihet edhe punimi i fugave, vendosja e lasnjeve kendore nga materiali inox. Fuga rreth dyerve punohet me selikon sanitar. Për nivelim të mirë të pllakave, përdorën kapset plastike. Ngjyra dhe disajni i pllakave patjetër caktohet nga menaxheri i kontratës. Të gjitha muret e nyjeve sanitare veshen me pllaka deri në lartësinë 2m. | $m^2$ | 154.2 | 23.00 | 3,547.52 |
| | | | | Total III | 3,601.52 |

| IV.Punët e Dyereve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| | Furnizimi dhe montimi i dyerve nga PVC me trashësi të profilit min 80mm, me ngjyrë të bardhë, korniza e përforcuar me profil të çelikut me trashësi t=2mm, hapësira në mes panelë pvc, Mekanizmi për hapje nga prodhuesi Roto, vinkHause ose ekujvalente. Dyert duhet të ankorohen me bulona te galvanizuar. Dyer duhet të kanë dim. si më poshtë: | | | | |
| IV.1 | Dyer me dim. 70x190cm | copë | 5.0 | 200.00 | 1,000.00 |
| IV.1 | Dyer me dim. 100x205cm | copë | 1.0 | 330.00 | 330.00 |
| | | | | Total VII | 1,330.00 |

| V. PUNET E ELEKRIKES | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | PËRSHKRIMI - TABELAT SHPËRNDARËSE DHE SIGURESAT | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| V.1 | Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x1.5mm² për ndriqim të nyjeve sanitare. Në çmim përfshihet edhe gypi pvc i brinjëzuar në gjatësi të kabllit. Shtrirja e kabllit për ndriqim behet nga priza me afërt. | m' | 35.00 | 1.00 | 35.00 |
| V.2 | Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x2.5mm² për furnizim me energji të prizave për tharsen e duareve. Në çmim përfshihet edhe gypi pvc i brinjëzuar në gjatësi të kabllit. Shtrirja e kabllit behet nën shkresen e estrihut nga tabela e shperndarse. | m' | 35.00 | 1.10 | 38.50 |
| V.3 | Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e prizave njëfazore 250V, 16A komplet me kuti pvc. Në çmim duhet të përfshihet hapja e vrimes dhe fiksimi i kutisë pvc në muri. | Copë | 5.00 | 2.00 | 10.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| V.4 | Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e ndërpresit 10A, komplet me kuti pvc. Në çmim duhet të përfshihet hapja e vrimes dhe fiksimi i kutisë në muri. | Copë | 5.00 | 2.00 | 10.00 |
| V.5 | Furnizimi dhe montimi i Paneleve për ndriqim, prodhim sipas standardeve CE, Korniza dim. 30x30cm, fuqia min. 40Vat, mbojtja min. IP56. | Copë | 7.00 | 10.00 | 70.00 |
| | | | | TOTALI V | 163.50 |

| VI. RRJETI I KANALIZIMIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | PËRSHKRIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| VI.1 | Hapja e kanalit me dimensione të nevojshme për punë për vendosjen e gypit kryesor të kanalizimit nga muri i nyjeve sanitare deri të puseta. Këtu llogaritet hapja e kanalit, furnizimi dhe vendosja e rerës rreth gypit , mbylimi i kanalit, si dhe hapja e vrimes Ø200 në pusetën ekzistuese të kanalizimit. | m' | 4.00 | 2.00 | 8.00 |
| VI.2 | Demolimi i serkllazhit të objektit dhe pllakës b.a në nyje sanitare një gjatësi 10m për nëvoja të shtrirjes së gypit Ø160mm për shole. Demolimi i pllakës behet në thellësin e nëvojshme për shtrirjen e dhe krijimit të ramjes së këtij gypit të kanalizimit për shole, pasi që shtresa e estrihut nuk është e mjaftushme për mbulimin e këtij gypi. | Komplet | 1.00 | 10.00 | 10.00 |
| VI.3 | Furnizimi, montimi dhe përforcimi i gypave të Geberit sipas standardeve dhe praktikave më të mira, më të gjitha pjesët fazonike | | | | - |
| VI.4 | Gyp Ø160mm ( nga puseta për shole) | m' | 20.0 | 1.00 | 20.00 |
| VI.5 | Gyp Ø75mm (për lavaman dhe ujëmbledhësa) | m' | 16.0 | 1.00 | 16.00 |
| VI.6 | Kthesa Ø160mm, 45°, 90° | copë | 15.0 | 1.00 | 15.00 |
| VI.7 | Kthesa Ø75mm, ≤≤45°, 90° | copë | 30.0 | 1.00 | 30.00 |
| VI.8 | T/Y Ø75/75mm | copë | 12.0 | 1.00 | 12.00 |
| VI.9 | T/Y Ø160/160mm dhe T/Y Ø160/75mm | copë | 10.0 | 1.00 | 10.00 |
| VI.10 | Redukus Ø160/75mm, | copë | 7.0 | 1.00 | 7.00 |
| VI.11 | Mbyllës Ø160mm | Copë | 1.0 | 1.00 | 1.00 |
| VI.12 | Furnizimi dhe montimi i ujembledhesve me dim. Afersisht 10x50cm nga matali anti koreziv -INOX | copë | 2.0 | 5.00 | 10.00 |
| VI.13 | Furnizimi dhe montimi i ujembledhesve me dim. 15x15cm nga matali anti koreziv -INOX | copë | 3.0 | 5.00 | 15.00 |
| | | | | TOTALI X | 154.00 |

| VII.RRJETI I UJISJELLESIT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | PËRSHKRIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| | Furnizimi dhe montimi i tubave të ujësjellësit Jakomini ne shtypje deri në 10bar. Në llogari me gypa të merren të gjitha pjesët fazonike, shtangueset, lidhëse te ndryshme dhe cdo element i pa specifikuar më poshtë. Llogariten ne metër gjatësi. | | | | - |
| VII.1 | uji i ftohtë: Ø 16 mm | m' | 70.00 | 0.40 | 28.00 |
| VII.2 | Gyp furnizues Ø25 për furnizim me uji nga puseta në oborr deri në kasetë shperndarse. Në çmim përfshihet edhe lidhëset, ventillat dhe elementet tjera të nëvojshme për lidhjen e këtij gypi në puset dhe në kasetë. | m' | 10.00 | 1.20 | 12.00 |
| VII.3 | Furnizimi me gjithë materialin e nëvojshëm, montimi dhe fiksimi në muri i kokave përfundimtare të gypit të ujit me të gjitha elementet përciellëse. Kokat duhet të jenë të kualitetit të lartë të tipit TDM ose ekujvalent dhe duhet të testohen për rrjedhje nën presion. | Copë | 12.00 | 10.00 | 120.00 |
| VII.4 | Furnizimi dhe montimi i kutisë për 12 kolektor, me te gjitha elementet percjellese, e cila shërbenë për vendosjen e kolektorëve te ujit. Kutitë vendosen në lartësi 25 cm nga dyshemeja. | Copë | 1.00 | 60.00 | 60.00 |
| VII.5 | Furnizimi me gjithë materialin e nëvojshëm dhe montimi i kolektoreve të ujit. Kolektorët duhet të jenë të kualitetit të lartë ( RBM ose ekujvalent) dhe duhet të kenë shenjën CE. Në çmim duhet të parashihen edhe gjysemlidheset. Çmimi llogaritet për një vrimë. | Copë | 12.00 | 40.00 | 480.00 |
| VII.6 | Furnizimi dhe montimi i fitingjeve për një kastë uji (me 12 kolektorë) siç janë: Ventill me holander 1', lidhese, vazhdues, kthesa nipel, mbyllës mesingu 1', reduktues, unazat dhe të gjitha elemente e materialet tjera të nevojshme për funksionalizimin e katër kasetave të ujit përfshirë furnizimin me uji, e që nuk janë përfshirë në këtë pjesë të paramasës. | Komplet | 1.00 | 10.00 | 10.00 |
| | | | | TOTALI X | 710.00 |

| VIII. ELEMENTET SANITARE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | PËRSHKRIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| VIII.1 | Furnizimi dhe montimi i lavabos për duar nga porcelani i klasit të parë, me dim. 55x45cm të varur në mure. Në çmimi llogariten edhe EK Ventilli, sifoni nga inoksi, aksesoret, pjesët lidhëse komplet, si dhe furnizimi dhe montimi i pasqyrës, 60x70cm. | Copë | 6.00 | 257.00 | 1,542.00 |
| VIII.2 | Furnizimi dhe montimi i baterisë për lavaman (Rubineta). Bateria duhet të jet nga materiali kromi, ti rezistoj presionit min 5 bar, dizajni i përshtatshëm për ambienet shkollor, të këtë garancion se paku 5vite (garancioni duhet të dorëzohet për secilën bateri). Bateria duhet të jetë më të gjitha elementet përciellëse për montim dhe gypat fleksibil brinoks. | Copë | 6.00 | 50.00 | 300.00 |
| VIII.3 | Furnizimi dhe montimi i VC guacave të klasit të parë, me dimensionet standarde për të rritur, se bashku me fontanën (rezervuarin e ujit) te montuar në gaucë dhe kroin për pastrim. Në çmimi te llogariten, EK vetilat, gypat fleksibil dhe pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni. | Copë | 6.00 | 260.00 | 1,560.00 |
| VIII.4 | Furnizimi dhe montimi i VC guaskës nga porcelani për persona me aftesi të kufizuar. Vc guacka duhet të montohet se bashku me fontanë, mekanizëm për fontanë, kapakun për ulje me amortizer dhe të gjitha elementet tjera përcillëse deri në funksionalizim, përfshirë edhe ek ventillin, gypat fleksibil nga brinoksi. Në çmim të përfshihet edhe pasqyra 60x70cm, dy mbajtësit qe ankerohen në muri në të cilet mbeshtetën personat me aftësi të kufizuar. Guska duhet të ngjitet mirë më selikon sanitar të bardh. Fontana me mekanizm duhet të këtë garancion se paku 5 vite nga prodhuesi. | Copë | 1.00 | 150.00 | 150.00 |
| | | | | TOTALI VIII | 3,552.00 |

| XIX.MAKINERIA | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| POS | PËRSHKRIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
| XIX.1 | Montimi i dy radiatorve ekzistues 22-60/60cm në vendin e përcaktuar ne projekt, duke ri-montuar gypat ekzistues. Në çmim përfshihen edhe furnizimi me mbajtës të ri të radiatoreve, ventillat hyrje dalje në radiator dhe çdo material që nëvojitet për salldimin e gypave ekzistues dhe përforzimin e tyre në mure. Pas përfundimit të punimeve duhet të ngarkohet e testohet rrjeti. | Komp | 1.00 | 20.00 | 20.00 |
| | | | TOTALI XIX | | 20.00 |

| RIKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM | | | |
|---|---|---|---|
| I. Punët e Dëmolimit dhe Çmontimit | Shuma | € | **156.44** |
| II. Punët e muratimit, suvatimit dhe ngjyrosjes | Shuma | € | **308.88** |
| III.Punët e Dyshemës dhe pllakave | Shuma | € | **3,601.52** |
| IV.Punët e Dyereve | Shuma | € | **1,330.00** |
| V. PUNET E ELEKRIKES | Shuma | € | **163.50** |
| VI. RRJETI I KANALIZIMIT | Shuma | € | **154.00** |
| VII.RRJETI I UJISJELLESIT | Shuma | € | **710.00** |
| VIII. ELEMENTET SANITARE | Shuma | € | **3,552.00** |
| XIX.MAKINERIA | Shuma | € | **20.00** |
| **VLERA TOTALE ME TVSH:** | **Shuma** | **€** | **9,996.34** |

**PLANI DINAMIK: 30 DITE PUNE**